



SHPALLJE

Bursa për studentë nga Komuna e Vushtrrisë 2025

Data e fillimit: Tetor 2025

Komuna e Vushtrrisë, Republika e Kosovës, dhe CITY College, Kampusi Evropian i Universitetit të Jorkut në Selanik, Greqi, së bashku ofrojnë dhjetë (10) bursa për studentët nga Komuna e Vushtrrisë, si në vijim:

Bachelor:

- Tri (3) bursa të plota për studime Bachelor në Shkenca Kompjuterike OSE Psikologji
- Tri (3) bursa të pjesshme me gjysmë pagese (-50%) për studimet Bachelor në Shkenca Kompjuterike OSE Biznes dhe Ekonomik OSE Psikologji OSE Shkenca Humane.

Master:

- Dy (2) bursa të plota për studime Master në Shkenca Kompjuterike OSE Psikologji
- Dy (2) bursa të pjesshme me gjysmë pagese (-50%) për studimet Master në Shkenca Kompjuterike OSE Biznes dhe Ekonomik OSE Psikologji OSE Shkenca Humane.

OSE

Programet ekzekutive MBA:

- Dy (2) bursa të plota për studime Ekzekutive MBA
- Dy (2) bursa të pjesshme me gjysmë pagese (-50%) për studime Ekzekutive MBA.

Bursat janë të vlefshme për vitin akademik 2025-26 (Data e Fillimit të programeve: Tetor 2025) deri në përfundim të programit të caktuar akademik.

Sipas kësaj iniciative, CITY College synon të mbështesë shkollimin e studentëve të jashtëzakonshëm që dëshirojnë të studiojnë në CITY College, Kampusi Evropian i Universitetit të Jorkut në Evropë dhe të marrin diplomë të njohur ndërkombëtarisht.

Të diplomuarit Bachelor dhe Master do të marrin diplomë nga Universiteti i Jorkut.

Të diplomuarit në programet ekzekutive të MBA-së do t'i marrin dy diploma: nga Universiteti i Jorkut dhe nga Universiteti i Strasburgut.

Studimet do të ofrohen në kampusin e CITY College, Kampusi Evropian i Universitetit të Jorkut në Selanik, Greqi.

CITY College, Universiteti i Jorkut Kampusi Evropian është institucion i veçantë akademik, i njohur gjerësisht në të gjithë rajonin për përsosmërinë e tij në arsim. CITY College e ka marrë statusin e Kampusit Ndërkombëtar nga Universiteti i Jorkut dhe është pjesë e komunitetit të Universitetit të Jorkut. Ai ofron një sërë programesh akademike, të cilat çojnë në diploma universitare të dhëna nga Universiteti i Jorkut, MB. Me studentë nga më shumë se 60 vende, ai shquhet si institucion vërtet ndërkombëtar.

Universiteti i Jorkut është universitet i njohur britanik që renditet vazhdimisht në mesin e universiteteve më të mira në MB dhe në Krye të *Russell Group* (d.m.th. 24 universitetet më të mira me hulumtime intensive). Është renditur në vendin e 10-të më të mirë në MB për ndikimin e tij në hulumtime, sipas *Kornizës së Ekselencës Kërkimore (REF) 2021*. Është një nga katër universitetet e vetme në Mbretërinë e Bashkuar që është vlerësuar me çmimin e **Artë për Mësimdhënie** dhe në **Dhjetë Universitetet më të Mira për Hulumtime** në vlerësimin e fundit kombëtar. Universiteti i Jorkut njihet gjithashtu si një nga universitetet më të mira në botë (i 146-ti në botë, *Times Higher Education World University Rankings 2025*).

Universiteti i Strasburgut është universitet prestigjioz francez që nxit inovacionin dhe përsosmërinë në arsim dhe hulumtim. Projektet e Universitetit arrijnë njohje ndërkombëtare dhe universiteti ka reputacionin e liderit në hulumtime, me 18 fitues të çmimit Nobel në historinë e tij, duke e vendosur kështu Universitetin e Strasburgut ndër më të mirët në botë.

INFORMATA TË RËNDËSISHME

Periudha e aplikimeve:	27 shkurt – 7 mars 2025	Kandidatët pritet t'i dorëzojnë të gjitha dokumentet e kërkuara me kopje në gjuhën shqipe dhe të përkthyer zyrtarisht në anglisht.
Afati i fundit për aplikim:	E premte, 7 mars 2025	Aplikacionin dhe dokumentacionin përkatës duhet ta dorëzoni deri të premten, 7 mars 2025, ora 10.00.
Dorëzimi i aplikacioneve:	Fizikisht	Aplikacionin dhe dokumentet tuaja duhet ta dorëzoni <u>drejtpërdrejt në Komunën e Vushtrrisë, Zyra e Protokollit.</u>
Testi i gjuhës angleze:	E shtune, 8 mars 2025 Ora: 15.00 – 17.00 Në Hotel Sirius Në Prishtinë	Testi i Gjuhës Angleze është i detyrueshëm për ata aplikantë që nuk posedojnë certifikatë të njohur të gjuhës angleze në kohën e aplikimit.

KOMISIONI PËRZGJEDHËS

CITY College, Kampusi Evropian i Universitetit të Jorkut është përgjegjës për procesin e përzgjedhjes. Procesi i përzgjedhjes do të ekzekutohet nga Komiteti i Bursave të CITY College bazuar në kërkesat dhe rregulloret e tij të pranimeve siç përshkruhet në vegëzat përkatëse më poshtë.

UDHËZIME PËR APLIKIMIN PËR BURSË

- Kandidatët duhet t'i dorëzojnë formularët e aplikimit dhe kopjet e **TË GJITHA dokumenteve të kërkuara.**
- Nëse ndonjë dokument është në gjuhën shqipe, ju kërkohet të paraqisni një kopje në gjuhën shqipe dhe përkthimin zyrtar të këtij dokumenti në anglisht.
- Të gjitha kopjet duhet të jenë të vërtetuara si origjinale nga një noter ose një agjenci e autorizuar përkthimi.
Nëse mungon një dokument i kërkuar, Komisioni i Bursave ka të drejtë ta refuzojë këtë aplikacion.

Vërejtje:

Ata që nuk kanë diplomuar ende, por presin të diplomojnë deri më **15 shtator 2025**, duhet t'i dorëzojnë të gjitha transkriptat e disponueshme deri më tani. Komiteti i Bursave do të vendosë në bazë të provave akademike të disponueshme në kohën e përzgjedhjes. Diploma e maturës ose e universitetit/kolegjit duhet të dorëzohet sapo të lëshohet.

PROCESI I PËRZGJEDHJES SË PËRFITUESVE TË BURSIVE

- Aplikacionet me TË GJITHA dokumentet e kërkuara do të dorëzohen fizikisht në Komunën e Vushtrrisë, Zyra e Protokollit deri **të premten, 7 mars 2025, ora 10.00.**
- Aplikantëve të nivelit Bachelor dhe Master pa asnjë nga kualifikimet e kërkuara në gjuhën angleze do t'u kërkohet të hyjnë në testin e gjuhës angleze. Testimi do të organizohet nga CITY College të shtunën, më 8 mars, nga ora 15.00-17.00, në Hotel Sirius në Prishtinë.
- Aplikimet do të shqyrtohen nga Departamentet Akademike të CITY College, Kampusi Evropian i Universitetit të Jorkut.
- Lista përfundimtare e përfituesve të bursave do të vendoset nga Komiteti i Bursave i CITY College.
- Rezultatet do të shpallen zyrtarisht në uebfaqen www.york.citycollege.eu
- Të gjithë aplikantët do të informohen me email për vendimin.

Në rast të ndonjë çështjeje të veçantë, mund të shkruani në gdikaos@york.citycollege.eu

Lexo këtu për bursat për Bachelor.

(Nëse jeni të interesuar për bursat për Master, shkoni në kapitullin përkatës më poshtë).

BURSAT PËR STUDIME BACHELOR

Tri (3) bursa të plota për studime Bachelor në Shkenca Kompjuterike OSE Psikologji

Bursat e Plota për studimet themelore (Bachelor) ofrohen sipas skemës së mëposhtme:

50% do të mbulohet nga CITY College (4,145 Euro në vit për student)

50% do të mbulohet nga Komuna e Vushtrrisë (4,145 Euro në vit për student)

Studimet Bachelor zgjasin 3 vite dhe bursat janë të disponueshme për një periudhë prej 3 vitesh për këto programe:

Departamenti i Shkencave Kompjuterike

- BSc (Hons) në Shkenca Kompjuterike
- BSc (Hons) në Shkenca Kompjuterike (Informatikë Biznesi)
- BSc (Hons) në Shkenca Kompjuterike (Teknologji të Ueb-it)
- BSc (Hons) në Shkenca Kompjuterike (Inteligjenca Artificiale dhe Shkenca e të Dhënave)

Psikologji

- BSc (Hons) në Psikologji

Tri (3) Bursa me pagesë të pjesshme (-50%) për Studimet Bachelor në:

- **Administrim Biznesi ose Ekonomik OSE**

- **Shkenca Humane OSE**

- **Shkenca Kompjuterike OSE**

- **Psikologji**

Bursat e pjesshme (-50%) për studimet themelore (Bachelor) ofrohen sipas skemës së mëposhtme:

50% do të mbulohet nga CITY College (4,145 Euro në vit)

50% do të mbulohet nga studenti (4,145 Euro në vit)

Studimet Bachelor zgjasin 3 vite dhe bursat me pagesë të pjesshme janë të disponueshme për një periudhë prej 3 vitesh për këto programe:

Departmaneti i Administrimit të Biznesit dhe Ekonomikut

- BA (Hons) në Studime Biznesi (Menaxhment)
- BA (Hons) në Studime Biznesi (Marketing)

- BA (Hons) në Studime Biznesi (Kontabilitet dhe Financa)
- BA (Hons) në Studime Biznesi (Hoteleri dhe Menaxhim të Turizmit)

Departamentet e Shkencave Humane

- BA (Hons) në Gjuhë, Linguistikë dhe Letërsi Angleze
- BA (Hons) në Komunikim dhe Media Digjitale

Departamenti i Shkencave Kompjuterike

- BSc (Hons) në Shkenca Kompjuterike
- BSc (Hons) në Shkenca Kompjuterike (Informatikë Biznesi)
- BSc (Hons) në Shkenca Kompjuterike (Teknologji të Ueb-it)
- BSc (Hons) në Shkenca Kompjuterike (Inteligjencë Artificiale dhe Shkenca e të Dhënave)

Departamenti i Psikologjisë

- BSc (Hons) në Psikologji

SHËNIME TË RËNDËSISHME

Përfituesit e bursave pritet të jetojnë në Selanik gjatë studimeve të tyre.

Bursat i mbulojnë tarifat e shkollimit dhe tarifat e regjistrimit. Prandaj, studentët duhet t'i mbulojnë shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe të jetesës me financat e tyre.

Nëse një student-përfitues i bursës nuk e ndjek programin për ndonjë arsye personale ose tjetër, atëherë bartësi i dytë i listës do ta zëvendësojë atë.

Studentët që do të pranohen me kusht (d.m.th. kur ndonjë dokument nuk është i disponueshëm në datën e dorëzimit) janë të detyruar ta dorëzojnë dokumentin që mungon në Universitet më së voni deri më 15 shtator 2025, përndryshe ata do të zëvendësohen me studentë në listën e renditjes.

KUSHTET E PAGESËS NGA STUDENTËT

Studentët që përfitojnë gjysmën (-50%) e bursës duhet të paguajnë për çdo vit studimi në dy (2) këste të barabarta: deri më 30 tetor dhe deri më 15 mars të çdo viti.

KUALIFIKIMI PËR BURSAT BACHELOR

Kandidatët për Bursat Bachelor duhet të plotësojnë kërkesat e pranimit të programit për të cilin po aplikojnë, siç përcaktohet nga CITY College, Kampusi Evropian i Universitetit të Jorkut. Ju lutemi lexoni ***Kushtet e pranimit dhe aplikimit në linkun më poshtë:***

TË NDRYSHOHET KJO Kushtet e pranimit dhe aplikimit për programet Bachelors

Kandidatët e kualifikuar për programet universitare duhet të dorëzojnë një Certifikatë të Përfundimit të Shkollës së Mesme (Matura sipas Ligjit) në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në anglisht (kërkohej përkthim zyrtar).

Kandidatët duhet të zotërojnë mirë gjuhën angleze, e cila vërtetohet me rezultat zyrtar të testit (d.m.th. TOEFL ose IELTS-Academic ose Duolingo ose një kualifikim ekuivalent/për një listë të plotë të kualifikimeve të pranueshme të gjuhës angleze nga Universiteti, ju lutemi vizitoni linkun e mësipërm për ***Kushtet e Pranimit dhe Aplikimit***).

Kualifikimi i gjuhës angleze duhet të jetë fituar brenda tri viteve të fundit, duke marrë parasysh datën e fillimit të studimeve tuaja në CITY College.

E RËNDËSISHME:

Kandidatët të cilët në momentin e aplikimit nuk e posedojnë asnjë nga kualifikimet e lartpërmendura të gjuhës angleze kanë të drejtë të aplikojnë për bursa me kusht që ata të hyjnë në testin e gjuhës angleze të Universitetit, i cili do të organizohet nga CITY College në Prishtinë (lexoni më poshtë për **Testin e Gjuhës Angleze***).

Megjithatë, pasi të pranohen në programin e interesit të tyre, studiuesit duhet të marrin diplomën IELTS ose TOEFL ose Duolingo ose provimet testuese ekuivalente gjatë vitit të parë të studimeve dhe t'i arrijnë rezultatet e kërkuara.

***TESTI I GJUHËS ANGLEZE**

Kërkesat e gjuhës angleze për studimet Bachelor janë dhënë qartë në linkun për *Kushtet e pranimit dhe aplikimit* të përmendura më sipër.

Aplikantët për bursa që nuk kanë asnjë kualifikim të gjuhës angleze, të përcaktuara sipas Kushteve për Pranim të Universitetit, do të duhet të hyjnë në testin e gjuhës angleze të organizuar nga Universiteti.

Ky test i gjuhës angleze do të organizohet në Prishtinë nga përfaqësuesit e CITY College, Kampusi Evropian i Universitetit të Jorkut:

Vendi: Hotel Sirius

Data: E shtune, 8 mars 2025

Ora: 15.00 – 17.00

(ju lutemi merrni me vete letërnjoftimin, një laps dhe stilolaps)

Megjithatë, studentëve që e kalojnë këtë test dhe marrin bursë do t'u kërkohej të hyjnë në provimin zyrtar të gjuhës angleze deri në fund të vitit të parë të studimeve (d.m.th. IELTS ose TOEFL ose Duolingo ose certifikatë ekuivalente).

Në vegëzat më poshtë mund t'i shkarkoni dokumentet për aplikim (duhet të plotësohen të dy formularët):

[Formulari i aplikimit për programet Bachelor](#)

[Formulari i Monitorimit për Mundësi të Barabarta](#)

Lexoni këtu për bursat Master / MBA

BURSAT për STUDIME MASTER ose MBA

Dy (2) bursa të plota për studimet Master në Shkenca Kompjuterike OSE Psikologji

Bursat e plota për studimet post-diplomike (Master) në Shkenca Kompjuterike ose Psikologji ofrohen sipas skemës së mëposhtme:

50% do të mbulohet nga CITY College (4,145 Euro për student)
50% do të mbulohet nga Komuna e Vushtrisë (4,145 Euro për student)

Studimet Master zgjasin 1 vit dhe bursat ofrohen për këto programe:

Departamenti i Shkencave Kompjuterike

- MSc në Inteligjencë Artificiale dhe Shkenca të të Dhënave (me orar të plotë/gjatë vikendeve)
- MSc në Zhvillim të Ueb-it dhe Aplikacioneve Mobile (me orar të plotë/gjatë vikendeve)

Psikologji

- MSc në Psikologji Këshillimore – Përgatitja e temës së diplomës
- MSc në Këshillim dhe Psikoterapi – Përgatitja e temës së diplomës
- MSc në Psikologji Klinike – Përgatitja e temës së diplomës

OSE

Dy (2) bursa të plota për studimet ekzekutive MBA

Bursat e plota për Studimet Ekzekutive MBA ofrohen sipas skemës së mëposhtme:

50% do të mbulohet nga CITY College (8,095 Euro për student)
50% do të mbulohet nga Komuna e Vushtrisë (8,095 Euro për student)

Dy (2) bursa me pjesë të pjesshme (-50%) për studimet Master

Bursat e pjesshme (-50%) për studimet post-diplomike (Master) ofrohen sipas skemës së mëposhtme:

50% do të mbulohet nga CITY College (4,145 Euro për program)
50% do të mbulohet nga studenti (4,145 Euro për program)

Studimet Master zgjasin 1 vit (programet me orar të plotë) dhe janë të disponueshme për këto programe:

Departamenti i Administrimit të Biznesit dhe Ekonomikut

- MSc në Financa dhe Menaxhim të Rrishtit
- MSc në Menaxhment (E përgjithshme)
- MSc në Menaxhment (Menaxhimi i Burimeve Njerëzore)
- MSc në Menaxhment (Menaxhimi i Logjistikës dhe Zingjirit të Furnizimeve)
- MSc në Neuromarketing
- MA në Marketing, Reklamim dhe Marrëdhënie me Publikun
- MA në Marketing Digjital dhe Media Sociale
- MSc në Analitikë Biznesore dhe Shkenca të Vendim-marrjes (me orar të plotë/gjatë vikendeve)

Departamenti i Shkencave Njerëzore

- MA në Linguistikë të Aplikuar me TESOL (me orar të plotë/gjatë vikendeve/online)

Departamenti i Shkencave Kompjuterike

- MSc në Inteligjencë Artificiale dhe Shkenca të të Dhënave (me orar të plotë/gjatë vikendeve)
- MSc në Zhvillim të Ueb-it dhe Aplikacioneve Mobile (me orar të plotë/gjatë vikendeve)

Departamenti i Psikologjisë

- MSc në Psikologji Këshillimore – Përgatitja e temës së diplomës
- MSc në Këshillim dhe Psikoterapi – Përgatitja e temës së diplomës

- MSc në Psikologji Klinike – Përgatitja e temës së diplomës

Dy (2) bursa me pagesë të pjesshme (-50%) për Studime Ekzekutive MBA

Bursat prej 50% për studime Ekzekutive MBA ofrohen sipas skemës së mëposhtme:

- 50% do të mbulohet nga CITY College (8,095 Euro për student)
- 50% do të mbulohet nga studenti (8,095 Euro për student)

Studimet Ekzekutive MBA zgjasin 2 vite dhe bursat janë të disponueshme për këto specializime:

- MBA në Menaxhment të Përgjithshëm
- MBA në Financa
- MBA në Marketing
- MBA në Menaxhim të Logjistikës dhe Zingjirit të Furnizimeve
- MBA në Menaxhim të Kujdesit Shëndetësor
- MBA në Menaxhim të Burimeve Njerëzore

SHËNIME TË RËNDËSISHME PËR STUDIMET MASTER

Përfituesit e bursave për programet Master të cilat mësohen gjatë ditëve të javës pritet të jetojnë në Selanik gjatë periudhës së studimeve të tyre.

Megjithatë, studentët për:

- MSc në Zhvillim të Uebit dhe aplikacioneve Mobile
- MSc në Inteligjencë Artificiale dhe Shkencë të të Dhënave
- MSc në Analitikë Biznesi dhe Shkenca të Vendim-marrjes

do të ndjekin mësimet në fundjava të caktuara dhe mund të zgjedhin të udhëtojnë në Selanik për orët e tyre të fundjavës.

Bursat mbulojnë tarifat e shkollimit dhe tarifat e regjistrimit. Prandaj, studentët duhet të mbulojnë shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe të jetesës me financat e tyre.

Nëse një student-përfitues i bursës nuk ndjek programin për ndonjë arsye personale ose tjetër, atëherë bartëso o dytë i listës do ta zëvendësojë atë.

Studentët që do të pranohen me kusht (d.m.th. kur ndonjë dokument nuk është në dispozicion në datën e dorëzimit) janë të detyruar të dorëzojnë dokumentin që mungon në Universitet më së voni deri më 15 shtator 2025, përndryshe ata do të zëvendësohen me studentë në listën e renditjes.

KUSHTET E PAGESËS NGA STUDENTËT

Studentët që fitojnë bursën prej 50% duhet të paguajnë tarifat e tyre në dy (2) këste të barabarta: deri më 30 tetor 2025 dhe deri më 15 mars 2026.

KUALIFIKIMI PËR BURSAT MASTER

Kandidatët për Bursat e Master duhet të plotësojnë kërkesat për pranim të programit për të cilin po aplikojnë, të përcaktuara nga CITY College, Kampusi i Universitetit të Jorkut në Evropë. Ju lutemi lexoni ***Kërkesat për Pranim dhe Aplikim në vegëzën më poshtë:***

TË NDRYSHOHET KJO Kërkesat për pranim dhe aplikim në programet Master

Kandidatët e kualifikuar për programet pasuniversitare normalisht duhet të posedojnë, ose pritët të fitojnë, një diplomë Bachelor me një notë të përgjithshme të mirë nga një Universitet ose një kolegji i akredituar sipas Ligjit të Kosovës.

Kandidatët duhet të zotërojnë mirë gjuhën angleze, e cila dëshmohet nga një rezultat zyrtar i testit (d.m.th. TOEFL ose IELTS-Academic ose Duolingo ose një kualifikim ekuivalent/për listën e plotë të kualifikimeve të gjuhës angleze që pranohen nga Universiteti, ju lutemi vizitoni vegëzën e mësipërme për ***Kërkesat për Pranim dhe Aplikim***).

Kualifikimi i gjuhës angleze duhet të jetë fituar brenda tre viteve të fundit, duke marrë parasysh datën e fillimit të studimit në CITY College.

E RËNDËSISHME:

Kandidatët të cilët në momentin e aplikimit nuk posedojnë ndonjë nga kualifikimet e lartpërmendura të gjuhës angleze kanë të drejtë për bursa me kusht që t'i nënshtrohen Testit të Gjuhës Angleze të universitetit, i cili do të organizohet nga CITY College në Prishtinë (lexoni më poshtë për ***Testin e Gjuhës Angleze****).

Megjithatë, pas pranimit në programin e tyre të interesit, studentët duhet t'i nënshtrohen testeve në IELTS ose TOEFL ose Duolingo ose provimeve testuese ekuivalente gjatë semestrit të parë të studimeve të tyre dhe të arrijnë rezultatet e kërkuara.

Studentëve që kanë përfunduar studimet bachelor në gjuhën angleze nuk u kërkohet të paraqesin një kualifikim të gjuhës angleze.

***TESTI I GJUHËS ANGLEZE**

Kërkesat e gjuhës angleze për studimet Master janë të përcaktuara qartë në vegëzën lidhur me ***Kërkesat E Pranimi dhe Aplikimi*** të përmendura më sipër.

Aplikantëve për bursa që nuk posedojnë ndonjë prej kualifikimeve të gjuhës angleze, të përcaktuara nga kërkesat e pranimit të Universitetit, do t'u kërkohet t'i nënshtrohen testit të gjuhës angleze të Universitetit.

Testi i gjuhës angleze do të mbahet në Prishtinë nga përfaqësuesit e CITY College, Kampusi i Universitetit të Jorkut në Evropë:

Vendi: Hotel Sirius

Data: E shtunë, 8 mars 2025

Ora: 15.00 – 17.00

(Ju lutemi të keni me vete letërnjoftimin, stilolapsin dhe lapsin)

Sidoqoftë, studentëve që kalojnë këtë test dhe fitojnë bursën do t'u kërkohet t'i nënshtrohen një provimi zyrtar të gjuhës angleze deri në fund të semestrit të parë të studimeve (d.m.th. IELTS ose TOEFL ose Duolingo ose certifikatë ekuivalente).

Ju mund të shkarkoni dokumentet e aplikimit (të dy formularët duhet të plotësohen) nga vegëzat e mëposhtme:

[Formulari i aplikimit për programet Master](#)

[Formulari i monitorimit të mundësive të barabarta](#)

SHËNIME TË RËNDËSISHME MBI BURSAT MBA EKZEKUTIVE

Emri i plotë i programit është:

Programi Pan-Evropian Ekzekutiv i diplomës së dyfishtë Master i Administrimit të Biznesit

[Programi Pan-Europian MBA Ekzekutiv](#) ofrohet gjatë TETË (8) fundjavave të gjata (e premte, e shtunë dhe e diel), pothuajse një herë në muaj.

Për më tepër, programi kërkon që të merrni pjesë në tre udhëtime studimore ndërkombëtare:

- (a) një udhëtim studimor në Universitetin e Jorkut, MB (për një njësi të gjatë plus një seminar)
- (b) një udhëtim studimor në Universitetin e Strasburgut, Francë (për një njësi të gjatë)
- (c) një udhëtim studimor në Selanik, Greqi (për dy njësi specializimi të mësuara plus një seminar)

Programi përfundon me paraqitjen e një teme të diplomës ose një projekti Industrial Capstone. Kohëzgjatja e programit është 24 muaj duke përfshirë Temën e diplomës/Projektin Industrial Capstone.

Studentët mund të zgjedhin të ndjekin programin MBA Ekzekutiv në cilëndo nga dy mënyrat e përshkruara më poshtë:

- Studime MBA Ekzekutive: 7 ligjërata me pjesëmarrje fizike, në klasë në Selanik, 1 ligjëratë e ofruar në internet, dhe tre udhëtime studimore ndërkombëtare

OSE

- Studime MBA Ekzekutive në formatin hibrid: ofrim i sinkronizuar në internet i të 8 ligjëratave, plus tre udhëtime studimore ndërkombëtare

Bursat janë të disponueshme për specializimet e mëposhtme MBA:

- MBA në Menaxhim të Përgjithshëm
- MBA në Financa
- MBA në Marketing
- MBA në Logjistikë dhe Menaxhim të Zinxhirit të Furnizimit
- MBA në Menaxhim të Kujdesit Shëndetësor
- MBA në Menaxhim të Burimeve Njerëzore

Bursat ofrohen për të dy mënyrat e studimeve, d.m.th. **Studimet MBA Ekzekutive** dhe **Studimet MBA Ekzekutive në formatin hibrid**

Shpenzimet e udhëtimit, akomodimi dhe shpenzimet personale në Selanik gjatë ligjëratave në fundjavë mbulohen nga studenti.

Kostot e udhëtimit, akomodimi dhe shpenzimet personale gjatë udhëtimeve studimore në Jork, MB; në Strasburg, Francë; dhe në Selanik, Greqi mbulohen nga studenti.

Nëse një përfitues i bursës nuk ndjek programin për ndonjë arsye personale ose tjetër, atëherë bartësi i dytë i listës do ta zëvendësojë atë.

Studentët që do të pranohen me kusht (d.m.th. një dokument nuk është në dispozicion në datën e dorëzimit) janë të detyruar të dorëzojnë dokumentin që mungon në Universitet më së voni deri më 15 shtator 2025, përndryshe ata do të zëvendësohen nga studentët në listën e renditjes.

KUSHTET E PAGESËS NGA STUDENTËT

Për programet MBA, pagesat nga studentët do të bëhen në katër (4) këste të barabarta: deri më 30 tetor dhe deri më 15 mars të çdo viti.

KUALIFIKIMI PËR BURSAT MBA

Kandidatët për Bursat e MBA duhet të plotësojnë kërkesat për pranim të programit, të përcaktuara nga CITY College, Kampusi i Universitetit të Jorkut në Evropë. Ju lutemi lexoni ***Kërkesat për Pranim dhe Aplikim në vegëzën më poshtë:***

***TESTI I GJUHËS ANGLEZE**

Kërkesat e gjuhës angleze për studimet MBA janë të përcaktuara qartë në vegëzën lidhur me *Kërkesat E Pranimi dhe Aplikimi* të përmendura më sipër.

Aplikantëve për bursa që nuk posedojnë ndonjë prej kualifikimeve të gjuhës angleze, të përcaktuara nga kërkesat e pranimi të Universitetit, do t'u kërkohej t'i nënshtroheshin testit të gjuhës angleze të Universitetit.

Testi i gjuhës angleze do të mbahet në Prishtinë nga përfaqësuesit e CITY College, Kampusi i Universitetit të Jorkut në Evropë.

Vendi: Hotel Sirius

Data: E shtunë, 8 mars 2025

Ora: 15.00 – 17.00

(Ju lutemi të keni me vete letërnjoftimin, stilolapsin dhe lapsin)

Ju mund të shkarkoni dokumentet e aplikimit (të dy formularët duhet të plotësohen) nga vegëzat e mëposhtme:

[Formulari i aplikimit për programin Ekzekutiv MBA](#)

[Formulari i monitorimit të mundësive të barabarta](#)